



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni vjeshtor

Kryesia e Kuvendit

P-037

Prishtinë, më 28 tetor 2008, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 28 TETOR 2008

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit, dhe anëtarët e Kryesisë: Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Eqrem Kryeziu, Ibrahim Gashi, Nexhat Daci, Naim Maloku, Xhezair Murati dhe Slllobodan Petroviq.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Arsim Avdiaj, Skënder Reçica dhe Sherif Konjufca;

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Mehmet Hajrizi dhe Eshref Vishi;

Nga NDI: Rinor Beka dhe

Nga OSBE: Petrit Hysaj.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës, si dhe me materialet e shpërndara për këtë mbledhje.

Ai propozoi edhe tri pika shtesë.

Kryesia, me propozim të Kryetarit, miratoi këtë

R e n d d i t e:

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 14 tetor 2008,
2. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i mocioneve, të rekomandimeve dhe të kërkesave, dhe
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 14 tetor 2008

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 14 tetor 2008, u miratua pa vërejtje.

2. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare të radhës

Kryetari i njoftoi anëtarët e Kryesisë me materialet e përgatitura për seancën e radhës.

Kryesia, me propozim të Kryetarit, pasi shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, vendosi që seanca plenare të mbahet më **6 nëntor 2008**, me këtë

R e n d d i t e:

1. Miratimi i procesverbaleve të seancave plenare, të mbajtura më 17 tetor 2008,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për bujqësinë dhe zhvillimin rural,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për faljen,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për themelimin e Departamentit për Mjekësi Ligjore
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për lizingun financiar,
7. Shqyrtimi i Rekomandimit për amendamentimin e Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të përkohshëm penal të Kosovës, nr. 03/L-002,
8. Shqyrtimi i Rekomandimit për amendamentimin e Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të përkohshëm të procedurës penale të Kosovës, nr. 03/L-003,
9. Shqyrtimi i Rekomandimit për amendamentimin e Ligjit për provimin përfundimtar dhe provimin e maturës shtetërore, nr. 03/L-018,

10. Shqyrtimi i Rekomandimit për amendamentimin e Ligjit për ndërprerjen e shtatzënisë, nr. 02/L-073,
11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Ansamblin e këngëve dhe të valleve “Shota” dhe për ansamblet e tjera, nr. 03/L-056,
12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për kualifikimet kombëtare, nr. 03/L-060.
13. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/7 për lëndën arkivore dhe arkivat, nr. 03/L-077,
14. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për produktet për mbrojtjen e bimëve, nr.03/L-042.
15. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për sigurinë private,
16. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri...për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionin të Konkurrencës,
17. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me propozimin e Qeverisë për emërimin e anëtarëve të Bordit të Trustit Pensional të Kosovës,
18. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Buxhet dhe Financa për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 02/L-74 për revizionin e brendshëm, dhe
19. Njoftimi i Grupit Parlamentar të SLS-së për ndërrimin e anëtarëve në komisionet parlamentare.

3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave

- 3.1 Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Bujqësi ... dhe të Komisionit për Buxhet e Financa lidhur me Projektligjin për ushqimin

Kryesia, pasi shqyrtoi rekomandimin e cekur më lartë, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Kërkohet nga Qeveria e Kosovës që Kuvendit t’ia paraqesë Deklaratën financiare për implikimet buxhetore të Projektligjit për ushqimin, sipas kërkesës së komisioneve funksionale.

- 3.2 Shqyrtimi i Kërkesës së anëtarëve të Panelit rekrutues për përzgjedhjen e Avokatit të Popullit për kompensim të anëtarëve të Panelit dhe të stafit mbështetës

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lartë, mori këtë

V E N D I M

1. Lejohet kompensimi i anëtarëve të Panelit rekrutues për përzgjedhjen e kandidatëve për Avokat të Popullit në shumën prej 50€, ndërsa 30€ për stafin mbështetës nga Administrata e Kuvendit për çdo mbledhje të mbajtur.
2. Kompensimi nga paragrafi një (1) i këtij vendimi të realizohet për secilin anëtar, në bazë të procesverbaleve mbi pjesëmarrjen e tyre në mbledhje.

3.3 Shqyrtimi i Kërkesës së deputetit Arsim Rexhepi për ta emëruar anëtar të Komisionit për Punë të Jashtme

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e deputetit Rexhepi, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Deputeti Arsim Rexhepi, në bazë të Rregullës 48.7 të Rregullores së Punës së Kuvendit, mund të marrë pjesë në mbledhjet e Komisionit për Punë të Jashtme, pa të drejtë vote.

3.4 Shqyrtimi i kërkesës së Grupit Parlamentar të LDD-së për ta ftuar në Interpelancë ministrin e Shëndetësisë, z. Alush Gashin.

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lartë, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Kërkesa e Grupit Parlamentar të LDD-së për ta ftuar në Interpelancë ministrin e Shëndetësisë, z. Alush Gashi, i dërgohet Qeverisë së Kosovës që ta shqyrtojë atë brenda shtatë (7) ditësh, në përputhje me Rregullën 25 të Rregullores së Punës së Kuvendit.

3.5 Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit Ad Hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës

Kryesia, pasi shqyrtoi rekomandimi e cekur më lartë, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

1. Miratohet kërkesa e Komisionit Ad Hoc për vazhdimin e afatit të konkursit për një (1) anëtar të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës nga radhët e komunitetit joshqiptar dhe joserb në Kosovë.
2. Miratohet kërkesa e Komisionit Ad Hoc për angazhimin e dy ekspertëve vendorë për ta ndihmuar Komisionin Ad Hoc në përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës.
3. Kërkohet nga Komisioni Ad Hoc që të përshpejtojë punën në përzgjedhjen e kandidatëve dhe Kuvendit t'ia paraqesë Raportin me rekomandime për emërimin e anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës.

4. Shqyrtimi i kërkesave për lejimin e udhëtimeve zyrtare jashtë vendit

Kryesia shqyrtoi kërkesat për lejimin e udhëtimeve jashtë vendit dhe vendosi, si vijon: deputetëve Lutifi Haziri dhe Ardian Gjini u lejohet udhëtimi zyrtar në Greqi, prej 23 deri më 26 tetor 2008; deputetëve Gani Koci, Myzejene Selmani dhe Safete Hadërgjonaj, u lejohet udhëtimi zyrtar në Shqipëri, prej 28 tetorit deri më 3 nëntor 2008; deputetëve Lutfi Haziri, Xhevdet Neziraj dhe Dragisha Miriq, u lejohet udhëtimi zyrtar në Zvicër, prej 28 deri më 30 tetor 2008; deputetja Gjylnaze Syla kishte tërhequr kërkesën, ngase nuk kishte udhëtuar për Zvicër; stafit udhëheqës të administratës së Kuvendi Ismet Krasniqi, Daut Beqiri dhe Isa Neziri, u lejohet udhëtimi zyrtar në Gjermani, prej 10 deri më 13 nëntor 2008, si dhe Fadil Bytyqit, i cili kishte shkuar në cilësinë e përkthyesit bashkë me kryetarët e grupeve parlamentare në Portugali, prej 23 deri më 25 tetor 2008.

5. Të ndryshme:

Kryesia u njoftua për vizitën e Grupit joformal të grave deputete në Shqipëri, si dhe me kërkesën e Grupit Parlamentar të SLS-së për ndërrimin e anëtarëve në komisionet parlamentare, të cilën e radhiti për seancën e ardhshme plenare.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 12:10 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Hartoi:

Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale